



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 275/2 Prot.

Tiranë, më 28.1.2019

VENDIM

Nr. 3, datë 28.1.2019

**“PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË KUOTAVE TË PRANIMIT  
DHE TARIFAVE TË SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË  
STUDIMEVE, SPECIALIZIME AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË, PËR  
VITIN AKADEMIK 2018-2019, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 25, neni 38, neni 42, neni 69, neni 78, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, Vendimit nr. 71, datë 22.11.2018 të Senatit Akademik të UMT-së, propozimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Drejtësisë, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

**VENDOSI:**

1. Kuotat e pranimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2018-2019, janë në total 309 (treqind e nëntë), të ndara si më poshtë:
  - a) Kuota pranimi të mbuluara për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 80;
  - b) Kuota pranimi për Ministrinë e Brendshme 2;
  - c) Kuota pranimi për Ministrinë e Mbrojtjes 20;
  - d) Kuota pranimi për Ministrinë e Drejtësisë 11;
  - e) Kuota pranimi të lira (pambuluara) 196;
2. Kuotat e pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata, me kohë të plotë, të përcaktuara në pikën 1/a, b, c, d, e, të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Kuotat e pranimeve për transferim studimesh (5 kuota) janë në mbështetje të kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar në nevojat e shërbimit shëndetësor për mjekë të specializuar. Studenti transferohet nga programe specializimi afatgjatë, të ngjashme, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Studentët e transferuar nuk

mund të regjistrohen në vite më të larta se viti i dytë i studimeve të programit përkatës specializues.

4. Aplikojnë, për programe studimi specializuese afatgjata, të gjithë kandidatët që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.
5. Pranimet e studentëve në programin specializues afatgjatë, në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar në këtë vendim, bëhen sipas përcaktimeve në rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, të miratuar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, si dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
6. Tarifa e aplikimit dhe konkurrimit (intervista me goje) në programet specializuese afatgjatë apo tarifa për transferim studimesh është 5000 (pesëmijë) lekë. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që ndjekin programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi është 115000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë (tarifa e konkurrimit/aplikimit dhe tarifa e shkollimit është e njëjtë me tarifën e vitit të mëparshëm akademik). Studentët e shpallur fitues paguajnë/arkëtojnë, menjëherë 30% të tarifës vjetore të shkollimit, ndërsa kështu e tjera arkëtohen sipas afateve dhe masës në përqindje të përcaktuara nga fakultetet përkatëse.
7. Studenti, i cilësuar, në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik, si përsëritës, i nënshtrohet tarifës së plotë vjetore të shkollimit, të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
8. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara sipas pikës 1/a, b, c, d të këtij vendimi, duhet të paraqesin, në momentin e aplikimit, shkresë mbështetëse nga ministria përkatëse. Studenti i shpallur fitues në kuotat sipas pikës 1/a, b, c, d të këtij vendimi, lidhin kontratën me ministrinë përkatëse.  
  
Modeli i kontratës dhe modalitetet e lidhjes së saj, detyrimet, penaltitetet në rast mosrespektimit të tyre, është përgjegjësi e ministrisë përkatëse, të cila kanë dhe detyrimin e njoftimit të kandidatit lidhur me këtë aspekt, para hapjes së procesit të aplikimeve.
9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i njësisë kryesore përkatëse, pa efekte buxhetore shtesë.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe i përcillet për zbatim Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Mjekësisë Dentare, ministrive përkatëse dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore për vijimin e mëtejshëm të procedurave të parashikuara në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë.

**KRYETARI**  
**ARBEN GJATA**

